

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve

---

**VENDIM**  
**Nr. 107 Datë 10.12.2010**

**PËR**  
**MIRATIMIN E NIVELIT TË KONSUMIT VJETOR TË**  
**ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË**  
**KLIENTIT TË KUALIFIKUAR PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të nenit 48, pika 1, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe Ligjit nr.9501 datë 3.4.2006 “Për Ratifikimin e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2010, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Vendosi :**

1. Për vitin 2011, të gjithë klientët tariforë (familjare dhe jo-familjarë) të energjisë elektrike kanë të drejtë të përfitojnë statusin e Klientit të Kualifikuar pavarësisht nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

---

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta”10  
Tirane  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22 963  
Tel +355 42 69 590  
[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)